

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji përberë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen juridike sipas padisë së paditësit ‘A.’ sh.p.k. nga....., kundër vendimit të të paditurës Dogana e Kosovës, 07.3/439, datë 28.04.2014, lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr.401/2016 datë 28.02.2017, në seancën e mbajtur më 24.10.2017, mori këtë :

### A K T G J Y K I M

Pranohet si e bazuar kërkesa e paditësit ‘A.’ sh.p.k. për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.401/2016 dt. 28.02.2017

Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Prishtinë, AA-UZH nr. 401/2016, datë 28.02.2017 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A-U nr.822/2014, datë 06.09.2016, kurse lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.401/2016 dt.28.02.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit ‘A.’ sh.p.k. paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, A-U nr. 822/2014 datë 06.09.2016, me të cilin është refuzuar e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit për anulimin e vendimit të të paditurës, 07.3./439 datë 28.04.2014.

Paditësi i ka paraqitur kësaj gjykate kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur, duke theksuar se aktgjykimi i kontestuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të së drejte materiale dhe dispozitave procedurale, duke propozuar që të dy aktgjykimet e kontestuar të prishen dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme mbajti seancën në përputhje me nenin 53 të LKA, ekzaminoi aktgjykimin e kontestuar, vlerësoi pretendimet e paraqitur në kërkesë dhe, pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës konstatoi:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.401/2016 dt.28.02.2017 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit 'A.' sh.p.k. kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Dep.administrativ në Prishtinë A.U.nr.822/2014 dt.06.09.2016 me të cilin është refuzuar kërkespadija e paditësit për anulim të vendimit e të paditurës Dogana e Kosovës 07.3/439 dt.28.04.2014.

Lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme gjeti se tani për tani nuk mund të pranohen si të drejta pikëpamjet juridike të gjykatave të instancave më të ulëta të paraqitura në aktgjykimet e tyre, të cilat janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të LKA dhe për këtë arsye të dy aktgjykimet u prishën.

Gjykata Supreme konsideron se gjykatat e instancave me të ulëta kanë kryer shkelje thelbësore të dispozitave të parashikuara nga nenin 182 par. 2 pika (n) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të zbatuar sipas nenit 63 të LKA. Kështu, në nenin 182 paragrafi 2. pika (n) të LPK parashikohet që shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë kur aktgjykimi ka të meta të tilla për të cilat nuk mund ekzaminohet, sidomos kur nuk përmban fare arsye ose kur nuk ka arsye për faktet vendimtare ose kur arsyet e paraqitura janë të paqarta, kontradiktore apo kur lidhur me faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie ndërmjet asaj që thuhet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së dokumenteve ose procesverbaleve.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se gjykata e instancave me të ulëta, nuk kanë parashtruar në aktgjykimet e tyre se cilat fakteve vendimtare janë të vërteta dhe ku e mbështesin vlerësimin e tyre, ndërkohë që arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kundërthënës. Përveç kësaj ka kundërthënie edhe ndërmjet asaj që thuhet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e dokumenteve. Kështu, gjykatat në fjalë theksojnë në arsyetimet e aktgjykimeve të veta 'se paditësi në procedurë të konfliktit administrativ ka paraqitur provat e lëndës (faturën e mallit, kontratën, transferin bankar dhe fatura tjera përcjellëse), e më pas theksohet se 'gjykata i pranon konstatimet në vendimin kontestues sa i përket detajeve të përfituesit sipas transferit bankar'. Gjithashtu gjykatat kanë konstatuar se në transferin bankar kemi një përfitues tjetër W. W.-Kinë, ndërsa sipas faturës përcjellëse dërgues i mallit është subjekti tjetër S. P. T. LTD-Kinë. Pra, 'pagesa e mallit edhe pse është bërë për të njëjtën faturë, nuk përputhet emri i dërguesit'. Gjithashtu, gjykatat kanë konstatuar se 'nuk harmonizohet vlera e transferit me vlerën faturale të mallit, pasi që transferi bankar ka vlerën e paguar prej 25,025 euro, ndërsa kjo vlerë nuk korrespondon me vlerën faturale prej 34,020 USD dhe faturën e shpenzimeve tjera manipulative prej 1.860,- USD të cilat i ka deklaruar paditësi në procedurën administrative'. Gjykatat në fund konstatojnë se 'transaksioni bankar që në këtë rast është prova vendimtare që do ta provonte vlerën reale të mallit sipas faturës përcjellëse të mallit nr. PLS .... dt..... dhe do të gjente mbështetje ligjore të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, gjykata nuk mund ta konsideroj si provë e bazuar për tu dëshmuar vlera reale'.

Gjykata Supreme tani për tani nuk mund t'i pranojë si të drejta këto pikëpamje juridike të gjykatave të instancave më të ulëta, sepse në arsyetimin e aktgjykimit të tyre nuk parashtrohen arsye për faktet vendimtare, kurse arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kontradiktore dhe ekzistojnë kundërthënie edhe ndërmjet arsyeve të aktgjykimit dhe përmbajtje së dokumenteve. Do të thotë, gjykatat e instancave më të ulëta, nuk kanë parashtruar në aktgjykimet e tyre arsye vendimtare kur gjatë vlerësimit të mallit janë bazuar në nenin 35 KDA, dhe pse i njëjti nuk ka mundur të vlerësohet sipas nenit 33 të KDA-së. Gjykatat në fjalë, në arsyetimet e aktgjykimeve të veta theksojnë se 'paditësi në procedurën administrative ka paraqitur provat e lëndës (faturën e mallit, kontratën, transferin bankar dhe faturat përcjellëse)' pa e përmendur faktin që vlera e mallit nuk ka mundur të vërtetohet duke e zbatuar nenin 33 të DKA-së, por është dashtë të aplikohet vlerësimi i mallit nga neni 35 të këtij ligji. Pikërisht, duke e marr parasysh faktin se paditësi gjatë zhdoganimit dhe gjatë procedurës gjyqësore ka paraqitur prova të lartcekura. Sipas mendimit e kësaj Gjykate, te çështja e vlerësimit të mallit (dhe të zbatimit e nenit 33 dhe nenit 35 të DKA) nuk është relevante se ne transferin bankar kemi një përfitues tjetër W.W.-Kinë, ndërsa sipas faturës përcjellëse të mallit është subjekti-dërguesi S. P. T. LTD nga Kina. Kjo nga fakti se nga marrëveshja në mes të dërguesit dhe porositësit-marrësit të mallit varet se, në emër të kujt do të bëhet transferi bankar.

Kjo Gjykatë nuk e pranon arsyetimin e paraqitur në aktgjykimet e kontestuara, në të cilat thuhet se nuk harmonizohet vlera e transferit me vlerën faturale të mallit, pasi që transferi bankar ka vlerën e paguar prej 25,025 euro, ndërsa ajo e shënuar në faturë vlerën prej 34,020 USD. Nisur nga kjo, mënyra e pagesës dhe monedha (valuta) e pagesës poashtu janë të varura nga marrëveshja në mes të porositësit-marrësit dhe dërguesit të mallit. Në rastin konkret, qëndron fakti se vlera faturale ishte e shprehur në valutë prej 34,020 USD, por kjo nuk do të thotë se pagesa duhet doemos të kryhet në valutën e njëjtë (USD). Pra, varet nga marrëveshja e porositësit dhe dërguesit të mallit dhe të konvertimit të monedhës(valutës), me kusht që vlerat e monedhave të përputhen me ditën gjatë së cilës është bërë konvertimi. Sipas mendimit e kësaj Gjykatë, tani për tani nuk mund të pranohen si të drejta këto pikëpamje juridike të gjykatave të instancave më të ulëta për mospranimin e transferit bankar të paditësit i cili ka dëshmuar vlerën e paguar sipas faturës.

Duke i shqyrtuar pretendimet e palës paditëse lidhur me zbatimin e gabuar të dispozitave materiale nga neni 33 KDA dhe pikëpamjen juridike të gjykatës së shkallës së dytë, me zbatimin e nenit 35 të njëjtit ligj, lidhur me metodën e VI-të, por edhe arsye të dhëna nga gjykata së shkallës së parë duke i zbatuar nenet 33-35 KDA, kjo Gjykatë vlerëson se në këtë çështje administrative janë të domosdoshme sqarime plotësuese për tu vërtetuar gjendja faktike. Poashtu, ekzistojnë kundërthënie edhe në interpretim. Gjykata e shkallës së dytë konkludon se DK ka vepruar drejtë dhe në bazë ligjore, dhe vendimin e saj e ka bërë sipas të dhënave të disponueshme marra nga Sektori i vlerës. Aktgjykimi i kontestuar kryesisht bazohet në provat të cilat i ka nxjerrë Sektori i vlerës - respektivisht Dogana e Kosovës, përmbajtja e së cilës nuk mund të jetë e mjaftueshme për zbatimin e nenit 33 apo 35 të KDA-së. Prandaj, kjo Gjykatë

vlerëson se nuk ka qenë e mundur të vërtetohet saktësisht gjendja faktike. Në rastin konkret, pos një propozimi të Sektorit të vlerës, nuk ekziston asnjë vendim tjetër valid nga ana e të paditurës. Kodi Doganor nuk parashikon se vlerësimi i mallit bëhet vetëm në bazë të një propozimi. Për këtë arsye, aktgjykimi është jo i plotë dhe nuk përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse në rastin e zbatimit të nenit 35 KDA, e që njëkohësisht paraqet shkelje të së drejtës materiale.

Duke vepruar në këtë mënyrë gjykatat e përmendura kanë bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e cila qëndron në faktin që ato nuk kanë vënë në dukje në aktgjykimet e veta se cilat fakte vendimtare janë të vërteta dhe ku e mbështesin vlerësimin e tyre, ndërkohë që arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kontradiktore. Nga gjithë sa u tha më sipër, aktgjykimet e kontestuara u desh të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruara që me rastin e riprocedimit, t'i mënjanojë të metat e përmendura më sipër dhe t'i vërtetojë faktet dhe provat që kanë të bëjnë me pretendimet e paraqitura në padi dhe në ankesë dhe, varësisht nga gjendja faktike e vërtetuar, duke zbatuar drejt të drejtën materiale, të vendosë lidhur me padinë e paditësit, duke marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Gjykata e shkallës së parë duhet t'i kushtojë kujdes të veçantë vërejtjeve të paraqitura në këtë aktgjykim.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 54 par.2 dhe 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
ARJ-UZVP nr. 38/2017 datë 24.10.2017

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit  
Nebojsa Boriçiq,

Përkthyesi,  
Ferid Abazi